REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 204, datë 4.3.2015

PËR

ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ENTIT SHTETËROR TË FARAVE DHE FIDANËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", dhe nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (ESHFF), në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor".

2. Të gjitha termat e përcaktuara në ligjin nr.10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim.

II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ENTIT SHTETËROR TË FARAVE DHE FIDANËVE (ESHFF)

1. ESHFF-ja, me seli në Tiranë, është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, me financim nga buxheti i shtetit.

CamScanner

2. ESHFF-ja ka si objekt të punës së saj zbatimin e kërkesave të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", si dhe të akteve nënligjore, të miratuara, në zbatim të tij.

3. Drejtori i ESHFF-së përfaqëson dhe drejton të gjithë veprimtarinë e ESHFF-së dhe raporton e përgjigjet para ministrit.

4. Drejtori i ESHFF-së përgatit dhe propozon për miratim, te ministri, rregulloren e brendshme të punës e sjelljes së personelit të institucionit.

5. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës të punonjësve administrativë të entit rregullohen me Kodin e Punës.

6. Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve:

a) ndjek procedurat për të gjitha hallkat e prodhimit, riprodhimit, shumëzimit, përpunimit dhe ruajtjes së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, deri në vendosjen e tij në treg;

b) monitoron rrjetin zonal për provat krahasuese për testim, të cilave u nënshtrohen varietetet e reja të prodhuara në vend ose të importuara për riprodhim, shumëzim e tregtim. Mbi bazën e rezultateve të provave krahasuese dhe metodave laboratorike bën vlerësimin, testimin dhe regjistrimin në Katalogun Kombëtar (KK);

c) ndjek kryerjen e kontrolleve fushore, marrjen e mostrave për kryerjen e analizave laboratorike për çdo material mbjellës dhe shumëzues bimor, që kërkohet të certifikohet, duke zbatuar kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore, për këtë qëllim;

ç) kryen aprobimin fushor për të gjitha ngastrat e mbjella, për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

d) pajis materialin mbjellës dhe shumëzues bimor me certifikatën zyrtare për çdo specie dhe varietet;

dh) kryen analizat laboratorike, në laboratorin e testimit të farave, për të gjitha mostrat e ardhura nga pikat zonale të testimit, sipas përcaktimit në ligjin nr.10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", dhe akteve nënligjore;

e) propozon tarifa të reja financiare, lidhur me shërbimet që kryen ESHFF-ja për çdo furnizues të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të cilat miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrit të Financave;

ë) në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, harton projektbuxhetin e

CamScanner

tij për vitin dhe vitet pasardhëse, për fondet që financohen nga buxheti i shtetit;

f) bën propozime për përmirësimin e standardeve të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor që vendoset në treg, shtesa dhe ndryshime të akteve ligjore e nënligjore për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor;

g) bashkëpunon me organizmat ndërkombëtare, si dhe me institucionet homologe të shteteve të tjera, për përditësimin e kritereve që aplikohen për testimin dhe certifikimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

gj) informon, periodikisht, MBZHRAU-në për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varietetet e reja, që janë në proces testimi apo regjistrimi në Katalogun Kombëtar, të specieve e varieteteve të reja të përditësuara, përdorimin e fondeve buxhetore nëpërmjet situacionit të shpenzimeve si dhe regjistrin e prokurimeve publike, etj.;

h) realizon të ardhura nga pagesat që bëjnë subjektet juridike e fizike për:

i. kryerjen e analizave të materialit mbjellës e shumëzues bimor;
ii. shërbimin e certifikimit zyrtar;
iii. testimin e varieteteve të reja, në prova krahasuese, në rrjetin zonal.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

EDMOND PANARITI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

ALBAN ZUSI

CamScanner

NR.PROT.313/1
DATË 5.3.2015

MINISTRISË SË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRIT TË SHTETIT PËR INOVACIONIN DHE
ADMINISTRATËN PUBLIKE
ENTIT SHTETËROR TË FARAVE DHE FIDANËVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

CamScanner